V E N D I M
Nr. 644, datë 21.11.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.481, DATË 19.7.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA PËR VITIN AKADEMIK 2001-2002 NË SISTEMIN ME SHKËPUTJE NGA PUNA, SI EDHE TARIFËN E SHKOLLIMIT PO PËR VITIN AKADEMIK 2001-2002", TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.566, DATË 22.10.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 dhe 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.481, datë 19.7.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me vendimin nr.566, datë 22.10.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "a" të pikës 2, kuota e pranimeve nga 7512 bëhet 7746, ndërsa kuota për degë të dytë dhe vite të ndërmjetme nga 250 bëhet 252.

2. Në shkronjën "b" të pikës 2 kuota kryesore nga 6539 bëhet 6714, ndërsa kuota dytësore nga 526 bëhet 583.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta